



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

V E N D I M

Nr. 6, datë 16.2.2016

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR FUNKSIONIMIN
E AGJENCISË SË BASENIT UJOR”

Në mbështetje të shkronjës “d”, të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullore së funksionimit të Agjencisë së Basenit Ujor, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Kreu III, i vendimit nr.3, datë 19.7.2002, i Këshillit Kombëtar të Ujit, “Për miratimin e rregullore së funksionimit të Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, Këshillit të Basenit Ujëmbledhës dhe Agjencisë së Ujit”, të ndryshuar, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.
3. Ngarkohen organet kombëtare të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

EDI RAMA

MINISTRI


EDMOND PANARITI



RREGULLORE
“PËR FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË BASENIT UJOR”

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Kjo rregullore ka si qëllim të përcaktojë rregullat e nevojshme që duhet të zbatojë Agjencia e Basenit Ujor në kuadër të kryerjes së funksioneve dhe detyrave, për realizimin e të cilave ajo është përgjegjëse.

Neni 2 Fusha e veprimit

Agjencia e Basenit Ujor zhvillon aktivitetin e vet në fushat e përcaktuara në dispozitat e ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, si dhe vendimet e Këshillit të Basenit Ujor përkatës (KBU).

Neni 3 Objektivat e rregullores

1. Të krijojë kornizën e nevojshme rregulluese për të realizuar një funksionim sa më të kontrolluar, efektiv dhe eficient të Agjencisë së Basenit Ujor.
2. Të krijojë një kornizë, e cila i krijon Agjencisë së Basenit Ujor detyrimin që në punën e saj të respektojë parimet e llogaridhënies, transparencës, hapjes dhe gjithëpërfshirjes.
3. Të mundësojë profesionalizëm dhe qëndrueshmëri në funksionimin e brendshëm të Agjencisë.

Neni 4 Baza ligjore

Hartimi dhe miratimi i kësaj rregulloreje të organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Basenit Ujor, mbështetet në ligjin nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", shkronja "d", pika 3, neni 9.

Neni 5 Përkufizime

Në funksion të kësaj rregulloreje, me termat e mëposhtëm nënkuptohen:

1. "Agjencia", ka kuptimin e Agjencisë së Basenit Ujor.

2. **“Akt”**, nënkupton llojin e vendimit me karakter të përgjithshëm ose individual që përgatit Agjencia e Basenit Ujor dhe miraton Këshilli i Basenit Ujor.
3. **“Autorizim”**, ka kuptimin e aktit administrativ, sipas përkufizimit në ligjin nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 13.
4. **“Detyra”**, ka kuptimin e funksioneve dhe përgjegjësiqe që i ngarkohen Agjencisë së Basenit Ujor, nga legjislacioni në fuqi.
5. **“Kërkesë”**, nënkupton kërkesat e subjekteve publikë dhe privat për dhënie autorizimi, leje ose për dhënie opinionimi, mbështetje për çështje, që kanë të bëjnë me rezervat ujore të basenit.
6. **“Projektakt”**, nënkupton projektvendimin me karakter të përgjithshëm ose individual që përgatitet nga Agjencia e Basenit Ujor për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e Këshillit të Basenit Ujor.

Të gjithë termat e tjera të përdorur në këtë rregullore kanë kuptimin sipas përcaktimeve në ligjin nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”.

KREU II ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

Neni 6 Struktura organizative e Agjencisë së Basenit Ujor

1. Agjencia është struktura në varësi të ministrisë përgjegjëse për administrimin e ujërave, e cila ngrihet dhe funksionon në çdo basen ujor, sipas përcaktimit të nenit 13, pika 1, të ligjit 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”.
2. Struktura organizative e Agjencisë së Basenit Ujor miratohet nga ministri përgjegjës për administrimin e ujërave.

Neni 7 Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë

Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë së Basenit Ujor, janë si më poshtë:

- a) Harton projektin e planit për burimet ujore për basenin e vet dhe e paraqet për miratim në KBU;
- b) Brenda kufijve të basenit të vet, harton inventarin e rezervave ujore në sasi, cilësi dhe i përditëson ato;
- c) Mban regjistrin ku shënohen të gjitha licencat, autorizimet, lejet, koncensionet e lëshuara, në përputhje me legjislacionin përkatës të ujërave;
- ç) Bashkëpunon me institucionet përgjegjëse për të siguruar cilësinë e ujit të pijshëm dhe cilësinë mjedisore të ujërave, bazuar në standardet e miratuara kombëtare;
- d) Dërgon të dhënat në Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujore, në bazë të formave dhe procedurave përkatëse të parashikuara me vendim të Këshillit të Ministrave;
- dh) Nxit pjesëmarrjen e përdoruesve të ujit në drejtimin dhe administrimin e burimeve ujore;
- e) Ndjek përmbushjen e detyrimeve financiare të përdoruesve të burimeve ujore;
- ë) Propozon plane financiare për financimin e investimeve të nevojshme në fushën e burimeve ujore;
- f) Shqyrton kërkesat për përdorim burimesh ujore, konform kërkesave të akteve ligjore/nënligjore në fuqi;
- g) Përgatit raportin përmbledhës për mbledhjen e radhës së KBU-së. Raporti së bashku me dokumentacionin që shoqëron çdo propozim në Agjenci, dërgohen për shqyrtim në Drejtorinë e Politikave të Burimeve Ujore;
- gj) Harton raporte dhe jep opinione për çështjet që kanë të bëjnë me burimet ujore të basenit dhe ja parashtron, sipas rastit, ministrisë, KBU-së ose Sekretariatit Teknik të KBU-së;
- h) Në bashkëpunim me institucionet kërkimore-shkencore, lokale apo kombëtare, përcakton fushat e studimit të burimeve ujore të basenit ujor, fondet e nevojshme për to dhe ndjek zbatimin e projekteve.
- i) Agjencia rekomandon punimet apo objektet me të nevojshme për bashkitë apo prefekturat, që bëjnë pjesë në basenin ujëmbledhës për zgjidhjen e problemeve që lidhen me burimet ujore;
- j) Agjencia, në bashkëpunim me organet qendrore dhe lokale, shqyrton projekte dhe programe për planifikimin e ujitjes, kullimit, mbrojtjes së brigjeve të lumenjve, liqeneve, etj. dhe ia paraqit për miratim Këshillit të Basenit;
- k) Në bazë të studimeve përkatëse hidrologjike dhe hidrogeologjike, Agjencia në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë identifikon zonat e mbrojtjes sanitare përreth burimeve ujore dhe i bën ato publike në faqen zyrtare të saj për autoritetet përkatëse dhe publikun e gjerë.
- l) Agjencia, kur e shoh të arsyeshme, i propozon institucioneve përgjegjëse për monitorimin dhe kontrollin e cilësisë së ujërave, që të kryejnë studime mbi shkallën e ndotjes së ujërave nga përdorimet në bujqësi, industri, ujë

të pijshëm dhe për përdorime të tjera publike. Bazuar në këto studime, agjencia dhe institucionet përgjegjëse për monitorimin dhe kontrollin e cilësisë së ujërave i propozojnë KBU-së dhe institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e cilësisë së ujërave, projekte dhe programe për uljen e shkallës së ndotjes brenda kufijve të miratuar kombëtarë.

Neni 8

Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtuesit të Agjencisë

Drejtuesi i Agjencisë ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) Harton përshkrimin e punës për çdo vend pune sipas përcaktimeve të ligjeve nr.152/2013, dhe nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”;
- b) Përgatit programet e punës vjetore e mujore dhe parashikon në planet mujore të punës të gjithë detyrat që i dalin Agjencisë sipas fushave përkatëse, ndjek sistematikisht plotësimin e tyre dhe çdo muaj bën analizën ekonomike në nivel Agjencie, në zbatim të detyrave të përcaktuara nga programet e miratuara;
- c) Bën shpërndarjen e punës dhe çështjeve që i adresohen Agjencisë dhe ndjek e kontrollon punën që bëhet nga specialistët;
- ç) Kontrollon dhe firmos të gjitha shkresat që përgatisin specialistët e Agjencisë në emër të saj;
- d) Kryejnë kontrole në terren për evidentimin dhe ndjekjen e problemeve të mundshme në fushën e ujërave, referuar një programi pune, të miratuar nga Drejtoria e Politikave të Burimeve Ujore;
- dh) Kryen analiza periodike lidhur me ecurinë e punës së Agjencisë dhe raporton çdo muaj pranë Drejtorisë së Politikave të Burimeve ujore në ministri për veprimtarinë e drejtorisë;
- e) Zbaton orarin zyrtar të punës dhe rregullat e etikës së nëpunësit civil;
- ë) Në rast se ka mangësi në stafin e agjencisë sipas profesioneve të kërkuara për përmbushjen e një detyre të caktuar që ka agjencia, drejtuesi i agjencisë ia cakton këtë detyrë punonjësit apo punonjësve brenda stafit, që ai i vlerëson si të përshtatshëm për përmbushjen e asaj detyre.

Neni 9

Detyrat dhe përgjegjësitë e specialistit të Agjencisë

Specialisti ka varësi direkte nga drejtuesi i Agjencisë.

Specialisti ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) Zbaton me përpikmëri dhe në nivel të lartë profesional të gjitha detyrat e ngarkuara dhe të marra përsipër;

- b) Jep përgjigje ligjore dhe teknike për problemet specifike që mbulon sipas detyrave që i ngarkohen brenda Agjencisë si dhe përpunon propozime lidhur me trajtimin e çështjeve të ndryshme me karakter profesional dhe teknik, për burimet ujore dhe i paraqet ato për ndjekje të mëtejshme tek drejtuesi i Agjencisë;
- c) Është përgjegjës për cilësinë dhe saktësinë e materialeve të përgatitura për mbledhjet e KBU-së;
- ç) Bën raportim me shkrim tek drejtuesi i Agjencisë mbi punën e kryer, sa herë i kërkohet nga drejtuesi;
- d) Kryen kontrole në terren për evidentimin dhe ndjekjen e problemeve të mundshme në fushën e ujërave, me autorizim të drejtuesit;
- dh) Punon në vazhdimësi për rritjen e aftësive vetjake tekniko-profesionale, në funksion të plotësimit sa më të mirë të detyrës së ngarkuar në fushën e menaxhimit të burimeve ujore brenda basenit, por edhe të karrierës në shërbimin civil, në njohjen dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi.
- e) Respekton orarin e punës dhe zbaton rregullat e etikës së nëpunësit civil në administratën shtetërore.

KREU III

PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE SHQYRTIMIT TË KËRKESAVE PËR PËRDORIM TË BURIMEVE UJORE

Neni 10

Paraqitja e kërkesës për leje/autorizim të përdorimit të burimit ujor

1. Subjektet private dhe publike, të cilët duan të zhvillojnë aktivitete që lidhen me përdorimin e ujit me leje, autorizim, paraqiten në Agjenci për të marrë formularët e nevojshëm që duhen plotësuar për këtë qëllim.
2. Dokumentacioni dorëzohet pranë Agjencisë në gjuhën shqipe (ose i përkthyer e noterizuar kur nuk është në gjuhën shqipe) në përputhje me vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave, KKU-së, Sekretariatit Teknik të KKU-së.
3. Agjencia regjistron materialin e paraqitur në regjistrin e posaçëm.
4. Subjekti paguan tarifën e shërbimit për çdo lloj kërkesë, konform vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave.

Neni 11

Shqyrtimi i kërkesave

1. Kërkesat për përdorim burimesh ujore që shqyrton Agjencia janë sipas përcaktimit në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.416, datë 13.5.2015, "Për miratimin e kushteve të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatin e vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit dhe vendimmarrjes, si dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore".
2. Në rast se kërkesa e bërë nga ana e subjektit nuk plotëson kërkesat e miratuara në legjislacionin në fuqi, dokumentacioni i kthehet subjektit kërkues për t'u plotësuar brenda një muaji nga data e njoftimit. Sa herë që materiali kthehet i korrigjuar, afati i ri fillon me dorëzimin e tij pas korrigjimit.
3. Agjencia shqyrton dokumentacionin e plotë të kërkesave për leje dhe autorizime, duke përpiluar një raport të detajuar për secilën kërkesë dhe duke shprehur me shkrim dhe mendimin e saj.
4. Draftraporti së bashku me dokumentacionin shoqërues për çdo propozim përcillen për shqyrtim pranë Drejtorisë së Politikave të Burimeve Ujore në ministri, e cila shprehet me një qëndrim brenda 10 ditëve.
5. Miratimi, në parim, i Këshillit Konsultativ së bashku me oponencën përkatëse të Drejtorisë së Politikave të Burimeve Ujore në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, dhe relacionin shoqërues të Agjencisë, prezantohen nga drejtuesi i Agjencisë, për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e radhës së KBU-së, sipas rregullores së KBU-së.

Neni 12

Pjesëmarrja në mbledhjen e KBU-së

1. Punonjësit e agjencisë kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjen e KBU-së, pa të drejtë vote.
2. Punonjësi i caktuar nga drejtuesi i agjencisë mban procesverbalin e mbledhjes, i cili mbahet në 3 kopje dhe firmoset nga të gjithë anëtarët e KBU-së të pranishëm.
3. Procesverbali, pas firmosjes, u shpërndahet anëtarëve të KBU-së, brenda pesë ditëve nga data e mbledhjes së KBU-së.

Neni 13
Zbardhja e vendimeve, autorizimeve dhe lejeve

1. Vendimi, leja apo autorizimi i miratuar në KBU-ja zbardhen nga agjencia, firmosen nga kryetari i KBU-së dhe siglohen nga drejtuesi i agjencisë brenda 7 ditëve nga data e miratimit.
2. Lejet/autorizimet për përdorim të burimeve ujore, të miratuara nga KBU-ja përditësohen në regjistrin kombëtar të lejeve.
3. Raporti përmbledhës i mbledhjes së KBU-së të dorëzohet në ministri brenda 10 ditëve nga data e firmosjes së akteve të miratuara. Raporti të përfshijë listën e akteve të miratuara.

Neni 14
Njoftimi i vendimit

1. Vendimi, leja apo autorizimi i miratuar duhet ti njoftohet dhe të jetë gati për t'iu dorëzuar subjektit brenda 5 ditëve nga data e firmosjes nga ana e kryetarit të KBU-së.
2. Subjekti të dorëzojë mandatin e pagesës së lejes/autorizimit në agjenci ditën e marrjes së aktit të miratuar.
3. Vendimi i miratimit me kusht nga KBU-ja, i dorëzohen subjektit pas plotësimit të kushtit të vendosur.

Neni 15
Vula dhe protokoli

1. Agjencia ka vulën zyrtare me të cilën identifikohet.
2. Vula ka formën dhe përmban elementët e përcaktuar në legjislacionin në fuqi për prodhimin, administrimin, kontrollin dhe ruajtjen e vulës zyrtare. Vula përmban shënimin identifikues "Agjencia e basenit Ujor"
3. Vula administrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe përdoret vetëm nga drejtuesi i Agjencisë.
4. Vula vendoset vetëm mbi firmën/nënshkrimin e drejtuesit të Agjencisë.
5. Në rast të konstatimit të humbjes apo dëmtimit të vulës, vihet menjëherë në dijeni drejtuesi i Agjencisë, kryetari i Këshillit të Basenit Ujor dhe Drejtoria e Personelit dhe Shërbimeve në ministri.

6. Dokumentacioni që hyn dhe del nga Agjencia protokollohet, ruhet dhe arkivohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.